



Shoqata “Shpresë për të Ardhmen”  
Bulevardi “Gjergj Fishta” Kulla 8 Ap.11 Tiranë  
Tel./Fax: (04) 224 033 E-mail: kape@albaniaonline.net

## RIINTEGRIMI I MIGRANTEVE TE KTHYER DHE KAPACITETET LOKALE

- Tryezë e rrumbullakët e organizuar nga Shoqata  
“Shpresë për të Ardhmen” -



Tiranë, 16 Prill 2004

# TRYEZA E LËNDËS

Rendi i ditës

**Fjala e mirëseardhjes. Prezantim i përgjithshëm.**

\*\*\*\*\*

**Prezantim: Rintegrimi i migrantëve të kthyer - një sfidë që duhet përballuar, nga Irena Dono, Drejtore Ekzekutive e Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen”.**

\*\*\*\*\*

**Strukturat që garantojnë rintegrimin dhe qëndrueshmërinë e kthimit të emigrantëve**

\*\*\*\*\*

**Bashkëndimi i punës ndërmjet OJF-ve që merren me migrimin dhe strukturave përkatëse të shtetit**

**Bashkia Tiranë**

**Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale**

\*\*\*\*\*

**Shërbimet ekzistuese që u ofrohen migrantëve të kthyer**

**Forumi për Riintegrimin Social Ekonomik**

**IOM Tirana**

**ICMC**

\*\*\*\*\*

**Dhënia e informacionit dhe ekspertizës për rintegrimin**

**Qendra e Mbështetjes së Migracionit**

**IOM Tirana**

\*\*\*\*\*

**“Historia ime e emigrimit”: Dy emigrantë të kthyer tregojnë historinë e tyre të migrimit, kthimit dhe riintegrimit**

\*\*\*\*\*

**Burimet ekzistuese të ndihmës si dhe pakësimi i donatorëve të huaj.**

**Patrice de Mestral, nismëtari dhe bashkëfinancuesi i projektit “Kape të Ardhmen”**

\*\*\*\*\*

**Shfrytëzimi i burimeve alternative, nxitja e sistemit të mikrokredive**

**Taleda- Unops**

**Swiss Contact**

\*\*\*\*\*

**Konkluzione dhe rekomandime**

\*\*\*\*\*

**Lista e pjesëmarrësve**

---

---

## R e n d i i d i t ë s

### **Tryezë e Rrumbullakët “Riintegrimi i Migrantëve të Kthyer dhe Kapacitetet Lokale”**

**16 Prill 2004, Tiranë.**

**9.00 Fjala e mirëseardhjes**  
Irena Dono, Drejtore Ekzekutive e Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen”

**Paraqitja e qëllimit të kësaj tryeze**  
Arben Muka, kryetar i bordit të shoqatës

**09.30 Riintegrimi i Migrantëve të Kthyer – një Sfidë që Duhet Përballuar**  
***Eksperienca e Projektit “Kape të Ardhmen”***  
Irena Dono

**10.00 Pyetje dhe diskutime**

**11.00 Pushim për kafe**

**11.15 Debat – i moderuar nga Arben Muka**

***Çështje për diskutim:***

- Strukturat që garantojnë riintegrimin dhe qëndrueshmërinë e kthimit të emigrantëve. Sa e përgatitur është shoqëria shqiptare me strukturat e saj të përballojë numrin e madh të emigrantëve që do të kthehen nga vendet e BE-së?
- Si mund të bëhen shërbimet ekzistuese më eficiente?
- Si mund të sigurohet dhënia e informacionit dhe ekspertizës për riintegrimin e emigrantëve të kthyer?
- Si mund të arrihet një bashkërendim më i mirë i punës mes OJF-ve që merren me migrimin dhe strukturave përkatëse të shtetit?
- Si mund të zhvillojme ne vetë si OJF programe të tilla pa mbështetjen e donatorëve të huaj? Si mund të bëhet Shqipëria një komb krenar që fillon të zhvillojë konceptet e veta për zhvillimin e ekonomisë shqiptare me sistem kredish të vogla që mund të ndihmojnë në riintegrimin e emigrantëve të kthyer dhe biznesin vendas?

**12.00 Konkluzione**

**12.30 Bufe**



## **FJALA E MIRËSEARDHJES**

### **Irena Dono- Drejtore Ekzekutive e Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen”**

Znj. Dono hapi takimin duke përshëndetur të pranishmit dhe duke i falenderuar thellësisht për pjesëmarrjen në këtë Tryezë të Rrumbullakët, e para e këtij lloji për shoqatën “Shpresë për të Ardhmen” që synonte të prezantonte një program të suksesshëm riintegrimi me një experience pesëvjeçare dhe të ballafaqonte praktikatat e deritanishme në shërbimet e ofruara për migrantët e kthyer.

Irena Dono shprehu gjithashtu keqardhjen për indiferencën e treguar nga ambasadat e huaja të akredituara në Tiranë, të cilat nuk dërguan asnjë përfaqësues të tyre, megjithëse ftesat dhe disa materiale shoqëruese informative ishin dërguar më shumë se një muaj përpara. Po kështu organizata donatore që veprojnë në Tiranë nuk dërguan konfirmim për pjesëmarrje.

## **PARAQITJE E PERGJITHSHME E TRYEZES SE RRUMBULLAKET**

### **Arben Muka, Kryetar i Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen”, moderator i Tryezës**

Pasi u uroi mirëseardhjen të gjithë pjesëmarrësve, Arben Muka i ftoi ata të bënin një prezantim të shkurtër të organizatave që përfaqësonin.

Më pas ai tregoi qëllimet dhe objektivat e Tryezës së Rrumbullakët, duke e vënë theksin gjithashtu te rëndësia e madhe që marrin në situatat që po jetojmë iniciativa të tilla që ndihmojnë në riintegrimin e migrantëve të kthyer.

“Fenomeni i emigracionit tashmë nuk është i ri për Shqipërinë; fillesat e këtij emigracioni të ri janë qysh në vitin '90 dhe problemet e lindura prej migrimit të paligjshëm janë të mëdha. Unë do të thoshja se me hapjen e negociatave për hyrjen e Shqipërisë në BE

dhe me nënshkrimin e marrëveshjeve të ripranimit të emigrantëve të kthyer mes qeverisë sonë dhe BE-së del si domosdoshmëri hapja e sa më shumë projekteve të riintegrimin për të riatdhesuarit nga këto vende. Në këtë kuadër mund të themi se, pa interesimin e drejtpërdrejtë të qeverisë dhe të pushtetit vendor, kontributi i OJF-ve vendase do të jetë i fragmentarizuar dhe i pandjeshëm sa duhet në realitetin e ashpër që pak shanse u ofron të rinjve të riatdhesuar”,- u shpreh Z. Muka.

## **“RIINTEGRIMI I MIGRANTËVE TË KTHYER- NJË SFIDË QË DUHET PËRBALLUAR” - prezantim i aktivitetit të Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen”**

### **Irena Dono, Drejtore Ekzekutive e Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen”**

Irena Dono bëri një prezantim të përgjithshëm të Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen” si edhe të projektit “Kape të Ardhmen” që financohen nga HEKS (Ndihma e Ndërkishës Zvicerane), EED (Ndihma për Zhvillim e Kishës Evangjeliste Gjermane) dhe IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin).

Ajo theksoi se jo pa qëllim i kishte vënë titullin prezantimit “Riintegrimi i Migrantëve të Kthyer, një Sfidë që Duhet Përballuar”, pasi procesi i riintegrimin është tejet i vështirë dhe i komplikuar dhe përbën një sfidë të vërtetë për ato shoqata apo institucione shtetërore që synojnë të merren me të.

I. Dono tregoi për hapjen e zyrës së Projektit “Kape të Ardhmen” në Prill 1999 dhe legalizimin e Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen” në Nëntor 1999 me qëllim që të ndihmonte në riintegrimin në shoqërinë shqiptare të migrantëve të kthyer nga vende të ndryshme evropiane, kryesisht nga Zvicra.

Zyra synonte të zhvillonte perspektiva të reja profesionale dhe arsimore për të ardhmen e këtyre të rinjve, me qëllim që t'i ndihmonte ata të gjenin dhe rizbulonin rrënjët e tyre në Shqipëri. Qysh nga 2003 e në vazhdim në program janë përfshirë edhe migrantë të brendshëm.

Më tej folësja citoi disa shifra për shqiptarët e riatdhesuar nga Zvicra pesë vitet e fundit. Këto shifra ishin një tregues për të theksuar faktin se sa i madh është numri i të riatdhesuarve vetëm nga Zvicra dhe sa e vogël mundësia për t'i ndihmuar këta njerëz nëpërmjet një projekti që, sado i suksesshëm të jetë, nuk mund të zgjidhë kurrësi këtë problem të madh. Është, pra, e rëndësishme të theksohet se hapja e sa më shumë programeve të ndihmës për këta migrantë të kthyer është një domosdoshmëri e kohës.

Programi i rinteprimit të të riatdhesuarve dhe migrantëve të brendshëm përfshin:

### **1. Riintegrimin profesional:**

- Mundësi për të fituar një profesion pranë bizneseve të vogla ose të mesme për një periudhë nëntëmujore.
- Lehtësim punësimi
- Mbështetje financiare për ndjekje studimesh të larta
- Mbështetje financiare për kurse trajnimi

### **2. Riintegrimin social**

Për këtë shërbejnë takimet e quajtura "Shtëpia e Hapur" ku të rinjtë bashkohen, shkëmbejnë eksperiencat e jetës dhe kalojnë disa orë të këndshme në shoqërinë e njëri-tjetrit.

### **3. Aktivitete riintegruese kulturore, sportive dhe aktivitete të tjera të kohës së lirë**

Këtu përfshihen vizita në qytete të tjera, vajtje kolektive në kinema ose stadium,

ndeshje futbolli midis të rinjve të projektit, organizimi i kremtimeve të veçanta, dhënia e çmimit vjetor për historinë më të mirë të emigrimit të shkruar nga të rinjtë e përfshirë në projekt etj.

### **4. Rritjen e ndërgjegjësimit për rrezikun e migrimit të paligjshëm.**

#### **Parandalimin e migrimit ilegal.**

Kjo bëhet nëpërmjet organizimit të takimeve dhe bisedave me të rinj të shkollave të mesme të qyteteve të ndryshme të vendit.

### **5. Mbështetje financiare për hapje biznesesh të vogla**

Që nga viti 2001 shoqata ka ofruar mbështetje financiare për hapje biznesesh të vogla për 4 grupe të rinjsh pas periudhës nëntëmujore të nxënies së zanatit si edhe për forcim biznesi ekzistues (dy raste)

#### **Shërbime të tjera të ofruara:**

- Këshillim psiko-social
- Ndihmë financiare për raste të veçanta përfituesish të programit në nevojë.

Gjatë prezantimit u dhanë disa statistika përmbledhëse në lidhje me numrin e të regjistruarve në zyrë, numrin e përfituesve të programit, që deri në fund të marsit 2004 kap shifrën 526, shtrirjen gjeografike në 26 rrethe të vendit etj.

Më tej u lexuan disa vlerësime të përfituesve për punën e shoqatës dhe projektit "Kape të Ardhmen" si edhe disa mendime dhe sugjerime të shprehura prej

tyre në takimet apo pyetësorët e plotësuar në përfundim të periudhës nëntëmujore të përfitimit të ndihmës për riintegrim.

Irena Dono përmendi me radhë donatorët që kanë bërë financuar këtë program riintegrimi dhe theksoi se partneriteti shumë i mirë me ta ka bërë të mundur që të arrihen objektivat e programit dhe të preket suksesi.

Në fund ajo vuri në dukje disa vështirësi të përjetuara nga zhvillimi i këtij projekti pilot në Shqipëri që kishin të bënin me një **target grup të vështirë, me përshtatjen e një programi të dizenuar në Zvicër që mezi gjeti terren në Shqipëri, me ndërgjegjësimin e të rinjve për dobinë e programit, sepse nga kjo varej se sa seriozisht dhe aktivisht do të angazhoheshin ata në procesin e riintegrit të tyre, me krijimin e kushteve për qëndrueshmërinë e rikthimit etj.**

U theksua se të kuptuarit dhe marrja pjesë aktive në programin e marrjes së profesionit për nëntë muaj dhe aktivitete të tjera mbështetëse është faktori kyç për qëndrueshmërinë e rikthimit.

Gjithashtu qëndrueshmëria e kthimit varet shumë nga stabiliteti i punishteve të biznesit të vogël që ofrojnë mundësi për mësim profesional dhe punë për të riatdhesuarit, çka është vështirë të gjendet në kushtet e sotme të biznesit.

Sipas prezantueses dobia e këtij programi riintegrimi qëndron në ofrimin e shanseve dhe mundësive migrantëve të kthyer për t'u rivendosur në një shoqëri dhe realitet që ndryshon shumë shpejt. Më qartë është faza e parë e procesit të riintegrit që përcakton nëse migranti i kthyer do ta kërkojë të ardhmen e tij në Shqipëri apo do të rinisë rrugën e emigrimit të pafat.

Në këtë kuadër **roli i strukturave pritëse nga ana e shtetit** merr një rëndësi të veçantë. Ato duhet të garantojnë jo njëanshmëri, por laryshi aktivitetesh për ta bërë procesin e riintegrit të plotë. Marrëveshjet e ripranimit të migrantëve të kthyer me disa vende të BE-së janë nënshkruar, disa të tjera priten të nënshkruhen më vonë, por lind pyetja: a është gati shteti ynë t'i presë ata?

Diçka që nuk duhet anashkaluar është çështja se në Shqipëri **ka një mungesë informacioni dhe ekspertize** në përgjithësi: migrantët që kthehen nuk dinë ku të drejtohen për të marrë një informacion të caktuar për vende pune apo çdo lloj tjetër informacioni që u duhet për të rifilluar jetën

në vend. Po të njëjtën gjë e kemi ndjerë edhe ne si shoqatë, shtu këtu edhe indiferencën dhe nganjëherë arrogancën e administratës sonë shtetërore që jo vetëm nuk të informon, por shpesh të dizinformon.

*Shënim: Prezantimin e plotë të aktivitetit të shoqatës, të bërë nga I. Dono mund ta gjeni në përmbyllje të këtij materiali.*

## Pyetje / Komente

Pas prezantimit nuk pati pyetje nga të pranishmit. Ndërsa përsa i përket komenteve mund të thuhet që pati një vlerësim pozitiv për punën e bërë gjatë këtyre pesë viteve nga të gjithë diskutantët që morën fjalën.

## **STRUKTURAT QË GARANTOJNË RIINTEGRIMIN DHE QËNDRUESHMËRINË E KTHIMIT TË EMIGRANTËVE**

Në këtë pikë debati i nxitur nga Z. Muka solli shumë komente që ndanë pjesëmarrësit me njëri-tjetrin. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve pohuan njëzëri që roli i qeverisë dhe i strukturave shtetërore është thelbësor në sigurimin e qëndrueshmërisë së rikthimit.

Për fat të keq përfaqësuesja e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale Znj. Silvana Banushi u largua shumë shpejt nga Tryeza e Rrumbullakët me pretekstin e punëve urgjente që i kishin dalë në Ministri, kështu që në këtë aspekt nuk mundëm të dëgjonim zërin e shtetit mbi legjislacionin ekzistues të migracionit dhe mbi atë çka mund dhe duhet t'u ofrojë shtetasve të vet në kuadër të riintegrit.

Nga të pranishmit u pohua njëzëri se rritja e bashkëpunimit midis OJF-ve dhe strukturave shtetërore, hartimi i politikave dhe strategjive të punësimit janë elementë kyç në përballimin e fluksit të migrantëve të kthyer, për t'i ardhur në ndihmë kësaj kategorie në procesin e riintegrit.

## **Bashkëndimi i punës ndërmjet OJF-ve që merren me migrimin dhe strukturave përkatëse të shtetit**

### **Bashkia e Tiranës**

Anila Shehu, shefe e Sektorit të Shërbimeve Sociale në këtë bashki.

A. Shehu bëri një prezantim të shkurtër të punës së bërë nga Bashkia e Tiranës në fushën e shërbimeve sociale. Sipas saj Sektori i Shërbimeve Sociale në Bashkinë e Tiranës është një sektor relativisht i ri, i krijuar në Janar 2001. Gjatë kësaj periudhe janë hasur probleme në lidhje me buxhetin dhe mungesën e eksperiencës. Përsa u përket migrantëve të kthyer, ekziston një strategji e së ardhmes, por në kuadrin ligjor ekzistues nuk përfshihen shërbime sociale dhe aq më pak mundësi punësimi apo strehimi.

Megjithatë folësja tha që Bashkia e Tiranës është prestigjioze dhe dëshira për bashkëpunim me shoqata dhe organizata të tilla që ofrojnë ndihmë për migrantët e kthyer do të ishte e mirëpritur. Ajo u shpreh se kishte informacion mbi Shoqatën “Shpresë për të Ardhmen” dhe Bashkia e Tiranës ishte e hapur të bashkëpunonte me të. Ajo përmendi gjithashtu një bashkëpunim me IOM Tirana në asistimin e një rasti.

Në vijim ajo i njohu të pranishmit me punën që është duke bërë Bashkia e Tiranës në përmirësimin e shërbimeve sociale. Aktualisht është duke u hartuar Harta e Shërbimeve Sociale ku do të përfshihen të gjitha organizatat qeveritare dhe jofitimprurëse që ofrojnë shërbime për pesë kategoritë e grupeve në nevojë. Gjithashtu po punohet për të ngritur një Këshill Social, i cili do të përzgjedhë projektet që do t'i paraqiten Bashkisë së Tiranës si edhe do të ofrojë ekspertizë në fushat përkatëse të projekteve që do të zbatohen.

### **Pyetje/Komente**

**Pyetje:** Çfarë strategjie është duke përdorur Bashkia e Tiranës në fushën e riintegritit?

**Përgjigje:** Anila Shehu shpjegoi faktin që shteti ynë ende nuk punon në një nivel politikash emigracioni dhe riintegrimi. Shteti shqiptar në bashkëpunim me IOM Tiranë kanë marrë përsipër të hartojnë strategjinë e emigracionit. Aktualisht janë në fazën e krijimit të strukturave.

Folësja theksoi edhe njëherë gadishmërinë e Bashkisë për të mirëpritur bashkëpunimet dypalëshe. Ajo përmendi dy fushat ku aktualisht Bashkia e Tiranës po punon intensivisht: investimet në godinat shkollore publike dhe trajtimi i problemit të strehimit.

### **Shërbimet ekzistuese që u ofrohen migrantëve të kthyer**

Aktualisht paralel me programin e shoqatës “Shpresë për të Ardhmen” në asistimin e migrantëve të kthyer kanë filluar të punojnë edhe disa OJF të tjera në nivel vendor dhe kombëtar.

**Forumi për Riintegrimin Social Ekonomik** është një prej tyre. Z. Luan Pogaçe përfaqësues i këtij forumi, pjesëmarrës në tryezën e rrumbullakët, foli shkurtimisht rreth punës që bëhet prej tyre. Deri tani puna e tyre ka qenë realizimi i një studimi në pikat kufitare të Kakavijës dhe Kapshticës me emigrantët që hyjnë e dalin nëpër këto pika kufitare. Sipas këtij studimi nevojat e këtyre njerëzve janë të natyrave të ndryshme dhe shpeshherë madje edhe mjaft komplekse. Plotësimi i këtyre nevojave kërkon një punë të specializuar dhe të ndërthurur edhe me ndihmën e ofruar nga shteti ynë.

L. Pogaçe solli eksperiencën e vet me emigrantët e kthyer nga Greqia. Ai u shpreh: “Kjo kategori njerëzish sapo kthehen forcërisht në pikën kufitare të Kakavijës është në mëshirë të fatit dhe kështu ekziston mundësia të bëhet pre e

veprimeve të paligjshme dhe të rrezikshme për individin dhe shoqërinë”.

Aktualisht Forumi për Riintegrimin Social Ekonomik është në fazën e mbledhjes së fondeve për zbatimin e një projekti që do t'u vijë në ndihmë emigrantëve që në momentet e para, pikërisht gjatë hyrjes ose daljes nga vendi.

Ai u shpreh që i vlerëson arritjet e deritanishme të Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen”, por theksoi edhe një herë që duhet të ketë një bashkëpunim midis OJF-ve që operojnë në fushën e emigracionit dhe shtetit. Gjithashtu programet e riintegrimit duhet të aplikohen për të gjithë kategoritë e të riadhesuarve, pavarësisht nga shteti ku ata kanë emigruar, dhe moshës së cilës i përkasin. Sipas tij ndihma duhet t'i jepet kësaj kategorie që në pikat hyrëse dhe të mos kapen një nga një nëpër qytetet e ndryshme të Shqipërisë, të mos lihen këta persona në mëshirë të fatit, shpeshherë pa asnjë para apo pa asnjë lloj ndihme. Kështu edhe punësimi i këtyre personave një nga një shpesh është edhe më i vështirë.

**Përfaqësuesja e IOM Tirana, Dëshira Shehu,** falenderoi stafin e Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen” për nismën e ndërmarrë duke e quajtur të efektshme dhe të frytshme.

Përsa i përket bashkëpunimit me Shoqatën “Shpresë për të Ardhmen” në kuadrin e programit VARRP (Programi i Asistencës për të Kthyerit Vullnetarisht), ajo nënvizoi faktin se IOM Tirana e konsideron veten jo thjesht si organizatë donatore, por si partnere me këtë shoqatë.

### **ICMC (Komiteti Ndërkombëtar Katolik për Migracionin)**

Nevila Gremi, përfaqësuese e ICMC, falenderoi gjithashtu Shoqatën “Shpresë për të Ardhmen” për nismën e ndërmarrë. Ajo foli shkurtimisht për një studim të përbashkët të kryer nga CESPI (Institut Kërkimor Italian) dhe ICMC ku edhe Shoqata “Shpresë për të Ardhmen” dha

kontributin e saj duke ofruar rastet për intervistim. Gjatë këtij studimi u realizuan një grup intervistash me familjarë të migrantëve të kthyer kryesisht nga Zvicra, por edhe nga shtete të tjera të BE-së, për të parë ndikimin e fenomenit të emigracionit në familjet shqiptare. Ky studim ishte faza e parë e një projekti që do të pasohet me implementimin e një programi riintegrimi për migrantët shqiptarë që janë duke vuajtur dënimin në burgje të ndryshme italiane. Një pjesë e mirë e këtyre personave synohet të trajnohen profesionalisht, në mënyrë që kur të kthehen në Shqipëri të zotërojnë dhe të ushtrorjnë një profesion të caktuar. Qëllimi i studimit ishte për të parë se sa të mirëpritur janë emigrantët kur kthehen dhe sa mundësi kanë ata që të integrohen në jetën dhe shoqërinë shqiptare.

### **Dhënia e informacionit dhe ekspertizës për rintegrimin**

Në lidhje me këtë çështje Dëshira Shehu, **përfaqësuese e IOM Tirana,** foli për punën e bërë nga IOM. Ajo përmendi veçanërisht investigimin dhe studimin që është bërë nga IOM gjatë vitit 2002 ku u intervistuan 31 të rinj, të cilët më pas u asistuan në kuadër të programit të riintegrimit VARRP. Pjesa më e madhe e tyre u ndihmuan për të gjetur një vend pune, disa për të kryer kurse të trajnimit profesional.

IOM Tirana ka krijuar gjithashtu një rrjet bashkëpunimi ku marrin pjesë OJF kombëtare dhe ndërkombëtare si edhe përfaqësues të institucioneve shtetërore. Ky rrjet funksionon nëpërmjet takimeve mujore të përfaqësuesve të OJF-ve, të cilët trajtojnë tema të ndryshme që lidhen me migracionin. Qëllimi i rrjetit është jo vetëm shkëmbimi i informacionit midis OJF-ve dhe dhënia e ekspertizës, por gjithashtu rrjeti funksionon si një strukturë e mirëfilltë lobuese për probleme të ndryshme që lidhen direkt apo indirekt me migrimin.

**Z. Luan Begaj,** Drejtor Ekzekutiv i **Qendrës së Mbështetjes së Migracionit,** foli për programin e kësaj qendre që ishte formuar në 2003.

Qendra kishte ofruar kurse profesionale për migrantët që punojnë në krahinën e Venetto-s (Itali); dhe po kryente studime dhe kërkime për çështjet e migrimit.

**Fokusi kryesor** i qendrës ishte migracioni ekonomik, punësimi dhe shërbimet për migracionin, asistimi i të rikthyerve si edhe kërkimet dhe studimet.

Sipas Z. Begaj emigrantët e kthyer vullnetarisht dhe ata të kthyerit forcërisht nuk duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë. Për ta duhet të ketë trajtime specifike dhe të specializuara. Veçanërisht të riatdhesuarit forcërisht kanë nevojë për një trajtim shumëplanësh.

“Gjatë kërkimeve që kryejmë, ne përqipemi të studijojmë mundësitë për t’i bërë më efikase shërbimet tona. Që të asistosh dikë duhen para dhe donatorët që i japin këto para shpesh të influencojnë ose drejtojnë politikën brenda programit. Në këtë këndvështrim ne duhet të këmbëngulim në pikat që janë më të rëndësishme për përfitimin e dhënien e ndihmës. Duhet të studiojmë mundësitë reale dhe individuale dhe mbi këto burime, të hartojmë strategjinë për shërbimet e mundshme. Tashmë është një fakt që dihet nga të gjithë që Evropa nuk do t’i mbajë më emigrantët. Ndërkohë, ne si organizata jofitimprurëse duhet të përgatisim terrenin e duhur për periudhën pas kthimit, duke qenë se shteti duket se ka dalë jashtë loje. Ne duhet të kemi parasysh që niveli ekonomik dhe i papunësisë të ne është në shifra alarmante dhe në kufij ekstremë, në një kohë që kthimet nga BE do të vazhdojnë të jenë masive”, - u shpreh Z. Begaj.

Gjithashtu sipas tij një OJF, edhe pse është një organizatë jofitimprurëse, duhet të zhvillojë një aktivitet fitimprurës në atë nivel që të bëjë të mundur zbatimin e projekteve të veta. Z. Bega theksoi domosdoshmërinë e bashkëpunimit me organizatat e huaja, pasi shteti shqiptar nuk ka kapacitetin e duhur për të përballuar fluksin e të riatdhesuarve.

## Pyetje/Komente

**Pyetje:** Sh. Kërpica (Përfitues i programit të Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen”)

Kur Shteti ynë nuk është në gjendje të presë emigrantët e kthyer, përse nënshkruan marrëveshje për kthimin e tyre?

**Përgjigje:** Dëshira Shehu, përfaqësuese e IOM Tirana, u përgjigj se Shqipëria është një nga shtetet që aspiron të futet në BE. Nënshkrimi i marrëveshjes së kthimit të emigrantëve është një nga kriteret që ajo duhet të përmbushë.

## “Historia ime e emigrimit”: Dy emigrantë të kthyer tregojnë historinë e tyre të migrimit, kthimit dhe riintegrimin

Në këtë Tryezë të Rrumbullakët ishin ftuar nga stafi i Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen” tre përfitues të programeve të saj. Dy prej tyre të projektit “Kape të Ardhmen” dhe një nga programi VARRP.

Ata pranuan të ndanin me ne historinë e tyre të emigrimit.

### Sh. Kërpica, Berat.

*“Pas mbarimit të shkollës së mesme vendosa të emigroja në Itali, duke qenë se qyteti im Berati nuk më ofronte asnjë mundësi punësimi. Atje kalova disa muaj herë me punë e herë pa punë, herë i ngrënë e herë jo. Një ditë më kapi policia dhe më pajisi më një dokument që vërtetonte se duhej të largohesha menjëherë nga Italia. Aty për aty vendosa të largohesha në Zvicër. Si fillim u paraqita në azil dhe kërkova azil politik. Gjatë kohës së qëndrimit atje vija rregullisht në shkollë dhe respektoja ligjet e shtetit zviceran. Por pas 6 muajsh më dërguan një letër, në të cilën thuhej se duhet ta lija Zvicrën për 3 ditë. S’e mendova gjatë dhe fillova të bëja gjithçka për të fituar ca para, rrugë e cila pas një muaji më çoi në burg. Pas një muaji më kthyen në Shqipëri. Në Rinas më priste familja ime.*

*Kur u ktheva i bëja shpesh pyetjen vetes “Çfarë do të bëj?”*

*Në qytetin tim të lindjes mësova për shoqatën “Shpresë për të Ardhmen”. U paraqita pranë*

zyrave të tyre për ndihmë dhe duhet të them që për 9 muaj kjo shoqatë më ndihmoi mjaftueshëm brenda mundësive të saj. Arrita të gjeja një punë dhe të kisha një pagesë normale për standartin e qytetit të vogël të Beratit që nuk të ofron shumë mundësi.

*Pas përfundimit të programit duhet të them se paga që merrja nga puna ime pa shtesën e dhënë nga shoqata "Shpresë për të Ardhmen" ishte shumë e vogël. Vendosa të ndryshoja profesion, por përsëri nuk kishte ndonjë diferencë kushedi se çfarë dhe nuk dihet sa do ta kem edhe këtë punë.*

*Unë personalisht e vlerësoj punën e bërë nga shoqata "Shpresë për të Ardhmen", por gjithashtu mendoj që puna e një shoqate të vetme është pak. Shteti duhet të bëjë më shumë për shtetasit e vet si edhe duhet t'i përkrahë dhe mbështesë këto iniciativa".*

## **Pyetje/Komente**

**Pyetje:** Gjatë qëndrimit tuaj në Zvicër kishit informacion për programet e kthimit dhe riintegrimit?

**Përgjigje:** Jo.

**Pyetje:** A do ta konsideroni riemigrimin?

**Përgjigje:** Në kushtet që ndodhem aktualisht, po. Shteti ynë nuk funksionon dhe ajo çfarë të mban në Shqipëri tani për tani është vetëm familja.

**Pyetje:** Çfarë do të të mbante në Shqipëri?

**Përgjigje:** Një punë me një pagesë të mirë. Njeriu duhet të jetë ambicioz në jetë. Unë nuk mund të kënaqem me pagën që marr aktualisht. Jam ende i ri dhe përpara kam një jetë të gjatë. Me pagën që marr nuk siguroj akoma kushtet normale për jetesë dhe jo më të mendoj për të vënë mënjanë ca para që do të më nevojiten për të ardhmen.

## **Silvana, Berat.**

"Nuk do të flas gjatë për kushtet dhe arsyet e emigrimit, pasi ato janë pothuaj të njëjta për të gjithë emigrantët shqiptarë.

Unë dua të ndaj me ju eksperiencën e kthimit dhe ndihmën e madhe që m'u dha nga Shoqata "Shpresë për të Ardhmen".

Unë jam kthyer në Shqipëri pas 5 vjetësh burgimi në Zvicër. Nuk dua të flas për atë çka bëra në Zvicër, sepse e di që ishte e gabuar, por të gjithëve na ndodh të gabojmë në jetë dhe të vuajmë pasojat e gabimeve tona. Unë jam kthyer në Nëntor dhe mund të them që në aeroportin e Rinasit më kanë trajtuar në mënyrë çnjerëzore forcat e rendit të aeroportit. Më kanë mbajtur të mbyllur 24 orë pa ujë dhe pa bukë, sikur të isha kriminele e shumëkërkuar, duke shkelur në mënyrë flagrante të drejtat e mia.

Më liruan vetëm pasi erdhi im atë në aeroport dhe hodhi firmën edhe pse unë isha 32 vjeç dhe konsiderohem të jem e aftë dhe me përgjegjësi të plotë për veten dhe jetën time. Ky ka qenë edhe momenti më i vështirë i jetës sime ku u përballa me një realitet të egër, shumë larg realitetit prej nga vija. Megjithatë, falë një mikeshës sime, u paraqita në zyrat e shoqatës "Shpresë për të Ardhmen", për programet e së cilës kisha dëgjuar nga punonjësi social i burgut ku unë vuaja dënimin në Zvicër. Për mua që nuk jetoj në Tiranë mund të them se kjo shoqatë ka bërë shumë, duke më dhënë një dorë për ta nisur jetën nga e para këtu. Unë kam disa muaj që jam përfshirë në program, jam duke u trajnuar në profesionin e parukieres dhe mund të them me bindje se është një ndihmë e konsiderueshme për mua".

## **Pyetje/Përgjigje**

**Pyetje:** A mund të na tregoni si shkuat në Zvicër?

**Përgjigje:** Së bashku me të fejuarin tim në rrugë klandestine.

**Pyetje:** Kur ishit në burg keni ushtruar ndonjë profesion?

**Përgjigje:** Kam punuar si kujdestare fëmijësh dhe në kuzhinë më tepër si ndihmëse dhe nuk është se mora ndonjë profesion.

**Pyetje:** Çfarë ndihme t'u ofrua nga Shoqata "Shpresë për të Ardhmen"?

**Përgjigje:** Si fillim mund të them se, që në momentin e parë kur u takova me punonjësen sociale, u ndjeva mirë, aspak e gjykuar dhe nuk pata problem të flas me të për jetën time dhe ato që më kishin ndodhur. Më pas shoqata më dha një ndihmesë të madhe, duke më mundësuar që unë të ushtrohem në profesionin e parukieres.

**Pyetje:** Do të doje përsëri të emigroje?

**Përgjigje:** Mendoj që jo. Jam kthyer në Shqipëri për të ndenjur. Ky është vendi im dhe këtu kam familjen, miqtë e mi.

**Pyetje:** Sipas mendimit tuaj çfarë do t'i mbante shqiptarët në vendin e tyre?

**Përgjigje:** Besoj një punë e qendrueshme me të ardhura të mira dhe më shumë përkujdesje dhe interes nga ana e shtetit për shtetasit e vet.

**Komente:** Teuta Grazhdani nga IOM Tirana bëri një koment të shkurtër në lidhje me mbërritjen e të deportuarve në aeroportin e Rinasit. Kjo kishte të bënte me eksperiencën e saj të mëparshme të punës në projektin "Kape të Ardhmen". Ajo tha se në përgjithësi shumica e personave të kthyer vijnë me mendjen për t'u larguar përsëri. Këtu ndikon edhe pritja që u bëhet atyre në aeroport që është jo rrallë jashtë normave të etikës dhe sjelljes njerëzore. Në këtë mënyrë as që mund të pretendohet që emigrantët e kthyer të joshen për të qëndruar në vendin e tyre.

Përfaqësuesja e Bashkisë së Tiranës tha se ishte absurde të kërkoje një punë të qendrueshme nga shteti, kur e ardhmja nuk ishte madje e sigurt për asnjërin prej nesh. "Të gjithë ne që jemi këtu sot e kemi një vend pune, por nesër ndoshta s'mund ta kemi".

Stavri Trako, manaxher i një shkolle jo publike, anëtar i bordit të Shoqatës "Shpresë për të Ardhmen" shtoi që shteti

ynë ka shumë borxhe dhe, sado të përpiqet, nuk ka realisht potenciale që të bëjë ndonjë gjë për shtetasit e vet apo për përmirësimin e politikave të punësimit.

Të gjithë pjesëmarrësit treguan interes të madh në dëgjimin e historive të emigrimit si dhe për kthimin dhe riintegrimin të treguara nga dy përfituesit e projektit "Kape të Ardhmen". Shumë prej tyre treguan interes edhe për librin me histori emigrimi "Në udhëkryqet e jetës" që është botuar kohët e fundit nga shoqata "Shpresë për të Ardhmen".

## **Burimet ekzistuese të ndihmës si dhe pakësimi i donatorëve të huaj.**

### **Patrice de Mestral, iniciator dhe një prej donatorëve të Projektit "Kape të Ardhmen"**

Z. De Mestral falenderoi të gjithë pjesëmarrësit për praninë e tyre në Tryezën e Rrumbullakët, gjithashtu anëtarët e bordit të Shoqatës "Shpresë për të Ardhmen", drejtorin ekzekutive të saj si edhe stafin e Projektit "Kape të Ardhmen" për punën e suksesshme të bërë në këto 5 vjet. Në veçanti ai shprehu kënaqësinë e tij për pjesëmarrjen në këtë Tryezë të Rrumbullakët të dy përfituesve të projektit "Kape të Ardhmen" që kishin ardhur enkas për këtë aktivitet nga qyteti i Beratit.

Duke bërë një prezantim të shkurtër për punën e tij si ideator i Projektit "Kape të Ardhmen" ai deklaroi se tashmë pas 5 vjetësh të shoqatës ka ardhur koha që ky projekt të shqiptarizohet.

"Që të jem i sinqertë, në hapat e para puna filloi për të mbajtur larg Zvicrës të huajt, konkretisht shqiptarët. Kështu nisi të zbatohej ky projekt. Megjithatë pas një pune të jashtëzakonshme nga i gjithë stafi u arrit që ky projekt të zhvillohej dhe të ngelet unik në Shqipëri. Shërbimet e para qenë për një target grup nga më të vështirët, të rinjtë shqiptarë të riatdhesuar nga Zvicra, të cilët kishin lënë atdheun e tyre nga varfëria me shpresën e një jetë më të mirë. Tashmë pas

5 vjetësh me shtrirjen e projektit po asistohen edhe të rinj të kthyer nga Gjermania apo Mbretëria e Bashkuar.

Unë mund të them me bindje që ka ardhur koha që ky projekt të kthehet në një institucion”, - u shpreh de Mestral.

Z. De Mestral vazhdoi fjalën duke folur për zhvillimet e shoqërisë shqiptare dhe për prioritetet e qeverisë shqiptare. Ai tha se ka qenë gjithsej 22 herë në Shqipëri dhe i ka bërë përshtypje fakti që qeveria ka prioritet më shumë rrugët dhe ndërtesat e reja që po bëhen dhe aspak emigrantët apo njerëzit që e përbëjnë Shqipërinë (të cilët për fat të keq rikthehen dhe largohen çdo ditë prej saj). Duke iu referuar përfaqësuesëve të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale që u larguan qysh në fillim, ai u shpreh me keqardhje: “Shteti Shqiptar e tregoi edhe një herë se ka të tjera prioritetet”.

Më pas ai foli për faktin e pakësimit të fondeve nga donatorët e huaj, të cilët gjithnjë e më shumë po largohen nga Shqipëria, duke e quajtur misionin e tyre të përfunduar dhe duke ia deleguar tashmë shtetit shqiptar përgjegjësinë. Tashmë është fakt se shumë donatorë të një pjese të madhe projektesh në Shqipëri janë tërhequr plotësisht ose pjesërisht, duke i krijuar kështu më shumë hapësira institucioneve shtetërore ose vetë sektorit të OJF-ve. Megjithatë ai shtoi se personalisht nuk do të tërhiqet kurrë nga ndihma për projektin “Kape të Ardhmen” dhe se do të përpiqet gjithmonë për jetëgjatësinë e tij.

## **Komente**

Stavri Trako shprehu mendimin që vendi ynë ende ka nevojë për mbështetjen e donatorëve të huaj, sepse aktualisht nuk është në gjendje të përballojë i vetëm problemet e mëdha që ka. Shtetet e zhvilluara evropiane të pasura me eksperiencë dhe me mundësi financiare duhet të derdhin kontributin e tyre për zhvillimin e shteteve më të vogla dhe të varfra për parandalimin e problemeve

madhore siç është edhe emigracioni. Problemet madhore ushtrojnë ndikimin e tyre negativ jo vetëm në vendin ku lindin, por pasojat e tyre ndihen edhe në vendet fqinje.

Denada Deliallisi u shpreh se tashmë nuk duhet të presim më nga të tjerët dhe se ka ardhur koha të përpiqemi vetë për mirëqenien tonë. Ajo iu referua shembullit të nënës me fëmijën e vogël, duke theksuar se ka ardhur koha që OJF-të të përpiqen të krijojnë mundësi për vetëfinancime, sepse ndihma nga donatorët e huaj nuk do të jetë e përjetshme.

## **Shfrytëzimi i burimeve alternative, nxitja e sistemit të mikrokredive**

Përsa i përket burimeve alternative të ndihmës për riintegrimin nga Shoqata “Shpresë për të Ardhmen” në vitin 2001 u aplikua skema e mikrokreditit për nxitjen dhe hapjen e bizneseve të vogla. Si rrjedhojë u ndihmuan 4 grupe përfituesish për të ngritur minibizneset e tyre. U ngritën 4 të tilla, nga të cilat vazhdon të funksionojë vetëm një prej tyre dhe konkretisht mobileria e quajtur nga djemtë e biznesit të vogël “Kape të Ardhmen”. Tre minibizneset e tjera falimentuan, duke shlyer vetëm një pjesë fare të vogël nga detyrimet e huasë. Arsyet e falimentimit të këtyre minibizneseve ishin të natyrave të ndryshme, qoftë për zgjedhje të biznesit të gabuar, mungesa e theksuar e energjisë elektrike gjatë vitit 2001, taksat e larta të vendosura nga shteti, konkurenca e ashpër e tregut të punës, impenjimi jo shumë serioz i sipërmarrësve dhe mbi të gjitha mungesa e ekspertizës. Ne arritëm t’u siguronim huanë, por nuk u dhamë ekspertizën e duhur.

**Arlinda Baçi**, përfaqësuese e agjencisë **TAULEDA-UNOPS**, përcolli një eksperiencë të suksesshme në këtë fushë. Puna e kësaj agjencie përfshihet në tre nivele: Në nivel qeverisjeje lokale, në nivel shoqatash që operojnë në qarkun e Durrësit dhe në nivel agjencish të zhvillimit lokal të qyteteve Durrës dhe Krujë.

Taleda-Unops funksionon si një institucion kredie për biznese të vogla dhe të mesme.

Ajo bashkëpunon me Bankën Credins, me të cilën ka lidhur marrëveshje për dhënie kredish.

Duke e njohur mirë territorin ku vepron, TAULEDA është mbështetëse idesh dhe iniciativash private. Ajo ofron ekspertizë si edhe konsulencë për ngritjen dhe mbështetjen e bizneseve të vogla.

## **Pyetje/Komente**

**Komente:** Në lidhje me sistemin e mikrokreditit Patrice de Mestral solli eksperiencën indiane të mikrokreditit të quajtur “Nga gratë për gratë”. Një grup grash indiane filluan të drejtonin një sistem mikrokrediti ku të ardhurat qarkullonin dhe administroheshin nga vetë gratë. Nisur nga kjo eksperiencë Z. De Mestral aludoi se stafi i Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen”, i cili përbëhet pothuajse vetëm nga gra, ashtu siç ka qenë i suksesshëm në punën e bërë deri tani, mund të jetë i tillë edhe në sistemin e mikrokreditit.

Arlinda Baçi deklaroi se Taleda do të ishte e gatshme për bashkëpunim me Shoqatën “Shpresë për të Ardhmen” nëse do të rifillonte të aplikonte skemat e mikrokreditit, duke ofruar eksperiencën dhe ekspertizën e duhur për ngritjen e bizneseve të vogla.

**Denada Deliallisi**, përfaqësuese e **SWISS Contact** (Fondacion Zviceran për Bashkëpunim Teknik) falenderoi stafin e Shoqatës “Shpresë për të Ardhmen” për organizimin e kësaj Tryeze të Rrumbullakët si dhe për ftesën. Ajo dha një informacion të shkurtër për aktivitetin e fondacionit.

Qëllimi i fondacionit ishte të rriste mundësitë e punësimit të personave që braktisin shkollat si dhe të rinjve pa asnjë lloj kualifikimi. Nëpërmjet projekteve të tij Swiss Contact ndihmonte në zhvillimin dhe pajisjen me aftësi profesionale të rinjve nëpërmjet kurseve trajnuese 3-4 mujore, të cilat janë përshtatur me nevojat e tregut të punës.

Drejtimet kryesore të aktivitetit ishin: - Rritja e cilësisë së mësimdhënies nga instruktorët; Rritja e numrit të profesioneve; Hapja e degëve në rrethe të tjera të Shqipërisë (aktualisht operohej në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut).

D. Deliallisi shpjegoi që fondacioni i tyre nuk u siguron punë individëve, por rrit mundësitë e tyre për t’u punësuar duke i trajnuar profesionalisht. PAGESA për kryerjen e kurseve profesionale bëhet nga Swiss Contact me një kontribut të vogël nga vetë individi.

## **Pyetje/Komente**

**Komente:** Arben Muka u shpreh që nëpërmjet dy OJF-ve mund të ketë një bashkëpunim të frytshëm, kur dihet se shumica e migrantëve të kthyer janë të rinj pa asnjë lloj kualifikimi apo profesion të mirëfilltë. Bashkëpunimi do të ishte një garanci më shumë në procesin e riintegritimit dhe qëndrueshmërisë së kthimit.

Dono dhe Deliallisi u shprehën se mundësia e bashkëpunimit është diskutuar edhe më parë midis tyre, duke shpresuar në konkretizimin e kësaj iniciative në të ardhmen e afërt.

Më pas Z. Muka e deklaroi të mbyllur aktivitetin duke falenderuar edhe një herë të gjithë pjesëmarrësit për praninë e tyre dhe i ftoi ata në bufenë e organizuar me këtë rast.

## **Konkluzione dhe rekomandime**

**Rritja e bashkëpunimit ndërmjet OJF-ve**  
Kjo është shumë e rëndësishme qoftë përsa i përket shpërndarjes së informacionit ashtu edhe për përmirësimin e shërbimeve ekzistuese që ofrohen për riintegritimin e migrantëve të kthyer. Gjithashtu për OJF-të që operojnë në fushën e migracionit është e rëndësishme që të kryejnë edhe studime ose kërkime të përbashkëta në këtë fushë.

### **Përfshirja e shtetit në riintegrimin e emigrantëve të kthyer**

Strukturat përkatëse shtetërore duhet t'i kushtojnë vëmendjen e duhur emigrantëve të kthyer, së pari duke i identifikuar ata dhe pastaj duke ndihmuar në lehtësimin e procesit të riintegrit në shoqërinë shqiptare dhe në tregun e punës. Bashkëpunimi me OJF-të që trajtojnë problemet e migracionit, përmirësimi i legjislacionit dhe politikave të migracionit si dhe hartimi i politikave të punësimit do të ishin elementë thelbësorë për të siguruar riintegrimin dhe qëndrueshmërinë e kthimit.

### **Hartimi i strategjive eficiente të integrit**

Hartimi i një strategjie kombëtare me përfshirjen e politikave për integrimin social ekonomik do të bënte të mundur përballimin e flukseve të emigrantëve të kthyer apo migrantëve të brendshëm.

### **Aplikimi i sistemit të mikrokreditit**

Të nxiten emigrantët e kthyer të aplikojnë për kredi afatgjata apo afatshkurtra sipas interesit dhe të ofrohet ekspertizë për ngritjen dhe forcimin e bizneseve të vogla. Të lobohet për krijimin e lehtësirave fiskale për biznesin e vogël.

### **Trajnime profesionale**

Të ofrohen më shumë mundësi trajnimi profesional për të rinjtë me nivel të ulët arsimor dhe profesional, duke i kualifikuar ata në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. Kjo mund të arrihet në sajë të një bashkëpunimi më të mirë me qendrat e formimit profesional dhe zyrat e punësimit.

# Riintegrimi i Migrantëve të Kthyer – një Sfidë që Duhet Përballuar

- Nga Irena Dono -

Prezantim i aktivitetit të Shoqatës  
"Shpresë për të Ardhmen"

Tiranë 2004

## Lënda:

1. Fillimet e projektit "Kape të Ardhmen" dhe krijimi i shoqatës
2. Objektivat e shoqatës
3. Disa shifra mbi shqiptarët e riatdhesuar nga autoritetet zvicerane
4. Drejtimet kryesore të aktivitetit dhe shërbimet e ofruara
5. Statistika
6. Vlerësimi i programit nga përfituesit. Mendime dhe sugjerime
7. Donatorët
8. Konkluzione që dalin nga përvoja

## **1. FILLIMET E PROJEKTIT "KAPE TE ARDHMEN" DHE KRIJIMI I SHOQATES "SHPRESE PER TE ARDHMEN"**

Projekti „Kape të Ardhmen“ filloi qysh në tetor 1998, por zyra e Informacionit, Këshillimit dhe Mbështetjes për të rinjtë e riadhesuar nga Zvicra u hap në Prill 1999.

Legalizimi i Shoqatës me emrin „Shpresë për të Ardhmen“ u bë në Nëntor 1999.

Projekti "Kape të Ardhmen" lindi si nismë personale e kapelanit zviceran të burgjeve Patrice de Mestral. Ai kishte pasur kontakte të shumta me të rinjtë shqiptarë të penalizuar në Zvicër dhe mendoi të hapte një program riintegrimi që synonte t'i nxiste këta të rinj ta krijonin të ardhmen e tyre në Shqipëri dhe jo në vende të tjera duke u marrë me veprimtari të paligjshme.

De Mestral u mor edhe me mbledhjen e fondeve kryesisht dy vjetët e para, por vazhdon të mbledhë edhe sot.

## **2. Objektivat e Shoqatës "Shpresë për të Ardhmen"**

- Të ndihmojë në riintegrimin në shoqërinë shqiptare të migrantëve të kthyer nga vende të ndryshme evropiane, kryesisht nga Zvicra, Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar.
- Të zhvillojë perspektiva të reja profesionale dhe arsimore për të ardhmen e këtyre të rinjve, me qëllim që t'i ndihmojë të gjejnë dhe rizbulojnë rrejtjet e tyre në Shqipëri.
- Të krijojë alternativa punësimi për këta shqiptarë të riadhesuar si hap i parë i riintegrimit të tyre në Shqipëri.
- Të promovojë integrimin social.
- Të bëjë objekt diskutimi publik problemin e të rinjve shqiptarë që nuk e shohin të ardhmen e tyre në Shqipëri, por duan të migrojnë në vende të tjera.
- Të rrisë ndërgjegjësimin e shqiptarëve për rreziqet e migrimit të paligjshëm.

### **TARGET GRUPI:**

- Migrantë të kthyer nga vendet evropiane, kryesisht nga Zvicra, Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar.
- Migrantë të brendshëm.

### 3. Disa shifra për shqiptarët e riadhesuar nga Zvicra pesë vitet e fundit

Këto shifra nuk janë të deklaruara zyrtarisht në publik, pasi nuk ekziston një praktikë e fillë në Zvicër dhe si rregull nuk mund t'i jepen publikut. Por këtu jepen shifra të përafërta, të cilat korrespondojnë me informacionet e marra nga Patrice de Mestral në policinë kufitare dhe në aeroportin e Klotenit. Këtu përfshihen shqiptarët e riadhesuar nga të gjitha kantonet e Zvicrës.

Viti	Persona të kthyer/ në vit	Në muaj rreth
1998	2543	212
1999	1613	134
2000	1100	82
2001	830	69
2002	415	35
2003	216	17

### 4. Drejtimet kryesore të aktivitetit \ shërbimet e ofruara

\* Riintegrimi profesional i migrantëve të kthyer ku përfshihen:

- Mundësi për të fituar një profesion pranë bizneseve të vogla ose të mesme për një periudhë nëntëmujore.
- Lehtësim punësimi
- Mbështetje financiare për ndjekje studimesh të larta.
- Mbështetje financiare për kurse trajnimi

#### Praktika e përdorur:

Për këtë nënshkruhet një kontratë me punëdhënësit ku zyra jonë merr përsipër të paguajë një shtesë page për përfituesin e programit me vlerën e 80 Euro-ve.

Numri i përfituesve të projektit është aktualisht 6 në muaj.

Që nga viti 1999 deri në vitin 2002 ishte 10 në muaj.

## **\* Riintegrimi social**

ku përfshihen: Takimet periodike të quajtura "Shtëpia e Hapur". Këto takime zhvillohen një herë në muaj në Tiranë dhe një herë në tre muaj në Shkodër dhe Berat.

Këto janë takime të lira, të hapura ku të rinjtë bashkohen me njëri-tjetrin, shkëmbejnë eksperiencat e jetës dhe kalojnë disa orë të këndshme në shoqërinë e njëri-tjetrit. Ato shërbejnë për të socializuar të rinjtë me njëri-tjetrin, për të krijuar miqësi të reja dhe për t'i nxjerrë nga rutina e jetës së përditshme.

Gjatë takimeve "Shtëpia e Hapur" vitin e kaluar u diskutuan gjithashtu një sërë temash, të përgatitura sipas një kalendari të caktuar nga punonjëset sociale.

Takime "Shtëpia e Hapur" u zhvilluan gjithashtu me biznesmenët e vegjël që kanë punësuar klientët tanë. Zyra jonë i kushton vëmendje të veçantë forcimit të marrëdhënieve me këta sipërmarrës.

## **\* Aktivitete riintegruese kulturore, sportive dhe aktivitete të tjera të kohës së lirë**

Këtu përfshihen vizita në qytete të tjera, vajtje kolektive në kinema ose stadium, ndeshje futbollit midis të rinjve të projektit, organizimi i kremtimeve të veçanta, dhënia e çmimit vjetor për historinë më të mirë të emigrimit të shkruar nga të rinjtë e përfshirë në projekt etj.

Dëshira e të rinjve për t'u përfshirë në këto aktivitete është e madhe dhe pjesëmarrja është e mirë. Ne kemi vënë re se riintegrimi si proces mund të bëhet më lehtë dhe do të ishte më efikas nëse do të zhvilloheshin më shumë aktivitete të këtij lloji.

## **\* Rritja e ndërgjegjësimit për rrezikun e migrimit të paligjshëm Parandalimi i migrimit ilegal**

- Organizimi i takimeve me të rinj të shkollave të mesme të qyteteve të ndryshme të vendit është pjesë përbërëse e aktivitetit të shoqatës sonë.
- Opinionet e të rinjve për rrezikun e migrimit të paligjshëm janë vjelë jo vetëm nga bisedat-debat, por edhe nga pyetësorët e shpërndarë për këtë qëllim. Të dhënat përkatëse janë botuar në numrat e buletinit të shoqatës.

## **\* Mbështetje financiare për hapje biznesesh të vogla**


- Që nga viti 2001 shoqata ka ofruar mbështetje financiare për hapje biznesesh të vogla për 4 grupe të rinjsh pas periudhës nëntëmujore të nxënies së zanatit si edhe për forcim biznesi ekzistues (dy raste).

## **\* Shërbime të tjera:**


- Këshillim psiko-social
- Ndihmë financiare për raste të veçanta përfituesish të programit në nevojë.

## 5. STATISTIKA


Të rinj të regjistruar në zyrat tona gjatë periudhës Prill  
1999- Mars 2004



Shtirirja gjeografike



Asistimi gjatë 5 viteve



## **6. Vlerësime të përfituesve për punën e shoqatës "Shpresë për të Ardhmen" dhe projektit "Kape të Ardhmen"**

Mendoj se puna e projektit "Kape të Ardhmen" është e mrekullueshme. Na ka ndihmuar dhe na ndihmon në integrimin tonë në shoqërinë shqiptare me plot probleme. Sugjerimi im i vetëm është që ky projekt të vazhdojë kështu me këto ritme.

### **G. Spahia (Shkodër)**

Ky projekt është një ndihmesë e mirëfilltë pasi jo vetëm që ndihmon ekonomikisht, por është edhe jetik për edukimin e brezit të ri, ingranimin në punësim dhe kthim në jetën normale sociale

Ju faleminderit ideatorëve dhe stafit të projektit.

### **N. Lubisha (Berat)**

Mendoj se projekti ka qenë mjaft i vlefshëm për personat që janë trajnuar në të. Mbështetja ka qenë jo vetëm financiare, por edhe morale në aspektin që të stimulon për të punuar dhe të ndryshon konceptin mbi përfitimin e të ardhurave. Mendoj që projekti të zgjerohet edhe në rrethe të tjera.

### **S. Dardha (Berat)**

Ky projekt ka shumë interes sepse ndihmon të rinjtë të punojnë dhe të mos merren me drogë në Zvicër. Kjo i ndihmon dhe i fut në rrugën e punës. Ju faleminderit.

### **B. Lamaj (Berat)**

Projekti është shumë i vlefshëm. Nëse do të vazhdojë kështu që të ndihmojë personat e kthyer në Shqipëri, ky projekt do të jetë një ndihmë materiale dhe morale. Stafit të projektit ishte tepër ndihmës dhe mbështetës me mua. I falenderoj shumë dhe iu uroj suksese të mëtejshme.

### **Z. Dauti (Tiranë)**

Ky kurs më ndihmoi të dilja në jetë dhe të mësoja një profesion si kuzhinier. E falenderoj këtë Shoqatë për ndihmën e dhënë dhe i sugjeroj të vazhdojë të ndihmojë të gjithë të riatdhesuarit si unë që të marrin një profesion të vlefshëm në jetë.

Ju faleminderit shumë. Faleminderit gjithë stafit të shoqatës për punën e mirë që bëjnë dhe për përkrahjen që më dhanë.

### **S. Doraci (Berat)**

Unë mendoj se projekti "Kape të Ardhmen" më ka ndihmuar brenda çdo mundësie dhe i falenderoj shumë.

Me respekt

### **A. Hakaj (Tiranë)**

## Mendime dhe sugjerime të të rinjve të përfshirë në program

- » Të hapen degë në rrethet kryesore të vendit
- » Të përfshihen në projekt të gjithë të rinjtë në vështirësi
- » Të ndihmohen familjet e varfra dhe me shumë anëtarë
- » Të jepen ndihmë financiare / minikredi afatgjata
- » Të shtohen aktivitetet social-kulturore sidomos në rrethe
- » Të zgjatet periudha e trajnimit apo suplementit të pagës
- » Të krijohen struktura të ndryshme për të arritur vetëfinancimin e shoqatës në të ardhmen  
= më shumë projekte!

## 7. DONATORE DHE PARTNERE

Projekti "Kape të Ardhmen" lindi si iniciativë e Z. Patrice de Mestral, i cili bëri edhe mbledhjen e fondeve në donatorë privatë zviceranë nga 1999 deri në fund të vitit 2000. Një kontribut ka dhënë edhe HEKS.

Gjatë viteve 2001-2002 shoqata u mbështet nga SDC (Agjencia Zvicerane e Kooperimit dhe Zhvillimit) në Bernë dhe HEKS (Ndihma e Ndërkishës Zvicerane). Nga 2001 deri 2003 HEKSI ka dhënë një ndihmesë të veçantë për monitorimin, trajnimin dhe këshillimin e stafit drejtues.

Në 2003 një donator i ri pranoi ta mbështeste për dy vjet shoqatën tonë: EED (Ndihma për Zhvillim e Kishës Evangjeliste Gjermane) dhe në vazhdimësi HEKS.

Në 2003 Shoqata "Shpresë për të Ardhmen" nënshkroi dy marrëveshje me IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin) për të bashkëpunuar në kuadrin e Programit VARRP (Ndihmë për Riintegrim për të Kthyerit Vullnetarisht) të iniciuar nga IOM Londër dhe për të përfshirë në programin e saj migrantë të kthyer nga Mbretëria e Bashkuar. Shoqata është financuar nga IOM për atë pjesë të përbashkët të programit që përmban marrëveshja dypalëshe.

Në 2003 disa donatorë privatë zviceranë, të cilët i kanë njohur arritjet tona në ndihmë të të riatdhesuarve, kanë pasur dashamirësinë të japin kontributin e tyre.

Duam të theksojmë se marrëdhëniet me donatorët ne i kemi konsideruar shumë të mira. Ato janë ngritur mbi baza partneriteti të barabartë dhe të sinqertë, çka i ka shërbyer ecjes përpara të aktivitetëve tona dhe mbarëvajtjes së shoqatës.

## 8. KONKLUSIONE QE DALIN NGA PERVOJA

Projekti "Kape të Ardhmen" nisi si një projekt pilot në Shqipëri dhe ne përjetuam shumë vështirësi, për arsye se:

**1. Target grupi ishte i vështirë.** Kishim të bënim kryesisht me të rinj që ishin marrë me veprimtari të palligjshme në Zvicër dhe ishin mësuar të fitonin para në mënyrë të shpejtë. Një program i fillë, i krijuar nga një zviceran ishte diçka e pakuptueshme për ta, madje ata dyshonin se mos ne kishim lidhje me policinë zvicerane. Pra, neve na u deshën disa muaj të shpalosnim aktivitetin tonë dhe të krijojmë besueshmërinë e zyrës.

**2. Përshtatja e programit** të dizenuar në Zvicër nga Patrice de Mestral, pra fara e sjellë nga Zvicra u desh disa kohë që të lëshonte rrënjë në Shqipëri. Ndërgjegjësimi i të rinjve për dobinë e programit ishte gjëja më e vështirë, sepse nga kjo varej se sa seriozisht dhe aktivisht do të angazhoheshin ata në procesin e riintegritimit të tyre. (Duhet të kemi parasysh këtu se në shumicën dërrmuese kemi të bëjmë me të rinj që kanë një nivel të ulët arsimor). Të kuptuarit dhe marrja pjesë aktive në programin e marrjes së profesionit për nëntë muaj dhe aktiviteteve të tjera mbështetëse është faktori kyç për qëndrueshmërinë e rikthimit.

**3. Qëndrueshmëria e kthimit** varet shumë gjithashtu nga stabiliteti i punishteve të biznesit të vogël që ofrojnë mundësi për mësim profesioni dhe punë për të riadhesuarit, çka është vështirë të gjendet në kushtet e sotme të biznesit.

**4. Mungesa e vendeve të punës** sidomos në rrethet na ka detyruar ne dhe të rinjtë tanë të mos kemi mundësi të zgjedhim vende pune me një garanci maksimale për mbijetesë në konkurrencën e pamëshirshme të tregut të punës. Megjithatë nga të dhënat e mbledhura nga pyetësorët rezultoi se mbi 80% e të rinjve tanë vazhdojnë të punojnë në të njëjtat pune edhe pas mbarimit të programit tonë, kjo shifër nuk na siguron plotësisht se qëndrueshmëria e kthimit është kryer në parametrat që do ta dëshironim të gjithë. Nga ana tjetër ne nuk mund të pretendojmë se u kemi dhënë këtyre të rinjve profesionin e jetës, sepse përndryshe do t'i mbyllnim rrugën zhvillimit dhe ambicjes pozitive për të ecur përpara.

**5. Dobia e këtij programi riintegrimi** për mendimin tim qëndron në ofrimin e mundësive migrantëve të kthyer për t'u rivendosur në një shoqëri dhe realitet që ndryshon shumë shpejt. Nëse një program të ndihmon menjëherë pas kthimit, të jep një dorë për të ecur përpara, kjo e lehtëson procesin tepër të vështirë dhe delikat të kalimit në dy shoqëri të ndryshme. Pra, është faza e parë e procesit të riintegritimit që përcakton nëse migranti i kthyer do ta kërkojë të ardhmen e tij në Shqipëri apo do të rinisë rrugën e emigrimit të pafat. Në këtë kuadër;

**6. Roli i strukturave pritëse** merr një rëndësi të veçantë. Ato duhet të garantojnë jo njëanshmëri, por laryshi aktivitetesh për ta bërë procesin e riintegritimit të plotë. Ajo çka ne si shoqatë kemi arritur të formulojmë dhe të përpiqemi ta realizojmë praktikisht është:

- *Atmosfera e ngrohtë e mirëpritjes që përbën etikën e zyrës*
- *këshillimi individual dhe në grup;*
- *ofrimi i shanseve të barabarta për të gjithë personat që vijnë aplikojnë për t'u përfshirë në program;*
- *evidentimi i nevojave si dhe i mundësive reale për riintegrim profesional*

- ofrimi i ndihmës nëpërmjet vendosjes së prioriteteve
- përfshirja në aktivitete të ndryshme e të gjithë të rinjve;
- bashkëpunimi me përfituesit dhe përfshirja e tyre në organizimin e aktiviteteve social-kulturore;
- mbajtja e kontakteve dhe mbështetja edhe pas përfundimit të 9-mujorit.

Unë mendoj se roli ynë si shoqatë është i kryer nëse ne mundohemi të realizojmë mirë programin që kemi përpara, kurse **roli i shtetit** është kompleks dhe duhet parë në shumë plane. E para: a evidentohen këta njerëz dhe a është menduar të ngrihen struktura pritëse për këta migrantë që kthehen?

Shteti shqiptar ka nënshkruar marrëveshje të ripranimit të migrantëve të kthyer me disa vende të BE-së, por lind pyetja: a është gati shteti ynë t'i presë ata?

**7. Në Shqipëri ka një mungesë informacioni dhe ekspertize** në përgjithësi: migrantët që kthehen nuk dinë ku të drejtohen për të marrë një informacion të caktuar për vende pune apo çdo lloj tjetër informacioni që iu duhet për të rifilluar jetën në vend. Po të njëjtën gjë e kemi ndjerë edhe ne si shoqatë, shtu këtu dhe indiferencën dhe nganjëherë arrogancën e administratës sonë shtetërore që jo vetëm nuk të informon, por shpesh të dizinformon.

Unë jam e mendimit se me një punë të përbashkët të OJF-ve dhe strukturave të shtetit që lidhen me problemet e emigracionit dhe punësimin riintegrimi i migrantëve të kthyer do të jetë një proces më i lehtë dhe me një kosto të përballueshme për shoqërinë shqiptare.

## Lista e pjesëmarrësve

Emër mbiemër	Organizata	Kontakte	E-mail
Irena Dono	Shpresë për të Ardhmen Tiranë	Tel. 04 224 033	kape@albaniaonline.net
Brunilda Qevani	Shpresë për të Ardhmen Tiranë	Tel. 04 224 033	kape@albaniaonline.net
Aurora Elezi	Shpresë për të Ardhmen Tiranë	Tel. 04 224 033	kape@albaniaonline.net
Kristaq Jorgaçi	Shpresë për të Ardhmen Tiranë	Tel. 04 224 033	kape@albaniaonline.net
Henrieta Troshani	Shpresë për të Ardhmen Tiranë	Tel. 04 224 033	kape@albaniaonline.net
Denada Deliallisi	Swiss Contact Durrës	Tel. 052 24229	denada@swisscontact.org.al
Nevila Gremi	ICMC	Tel. 04 374 424	hiscock@icmc.net
Luan Pogaçe	Forumi për Integrim Social Ekonomik	Tel. 04 227173 Cel. 0682229860	luanpogace@yahoo.com
Arlinda Baçi	Taleda Unops Durrës	Tel. 052 24837 Cel. 0682060838	aarlindab@yahoo.com
Dëshira Shehu	IOM Tirana	Tel. 04 271628	dshehu@iomtirana.org.al
Teuta Grazhdani	IOM Tirana	Tel. 04 271628	teutagrazhdani@iom.org.al
Dhimitraq Stratobërdha	Drejtoria e Shëndetit Publik Tiranë	Cel. 0682151655	
Anila Shehu	Bashkia Tiranë Sektori Shërbimeve Sociale	Tel. 04 2240 66 (139)	
Margalina Sina	Agjencia Gulliver Ok	Cel. 0692091325	linasina2002@yahoo.com
Valentina Pjeshkazini		Cel. 0682677272	
Stavri Trako	Shkolla dhe Fondacioni Horizont	Cel. 0682255414	
Marianne de Mestral	Weingartenstr. 47 CH-8708 Männedorf Switzerland	Tel. 0041 1 9202737	marianne.demestral@bluewin.ch
Patrice de Mestral	Weingartenstr. 47 CH-8708 Männedorf Switzerland	Tel. 0041 1 9202737	patrice.demestral@bluewin.ch
Genci Pjetri	IOM Tirana	Tel. 04 271628	gpjetri@iomtirana.org.al
Arben Muka	DWelle radio	Cel. 0692033366	mukaben@hotmail.com
Luan Begaj	Qendra e Mbështetjes së Migracionit	Tel. 04 363526	prouce@icc-al.org
Kastriot Mehmeti	Qendra e Mediave ABC	0682209783	mehmetikaci@hotmail.com
Silvana Banushi	Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale,		MPCS@yahoo.com
Loreta Mejdani	Përfituese e programit VARRP	Tel. 04 350792	
Silvana Nano	Përfituese e Projektit Kape të Ardhmen	Cel. 0692333951	kape@albaniaonline.net
Shyqyri Kërpica	Përfitues i Projektit Kape të Ardhmen	Cel. 0682294554	kape@albaniaonline.net